GJYKATA EUROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I KATËRT
ÇËSHTJA PUTO DHE TË TJERËT KUNDËR SHQIPËRISË
(Aplikimi nr. 609/07)

AKTGJYKIM
STRASBOURG
20 korrik 2010

Ky aktgjykim do të bëhet i formës së prerë në rrethanat e parashikuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund të bëhet objekt i korrektimeve redaktuese.

Në çështjen Puto dhe të Tjerët kundër Shqipërisë,

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt) e mbledhur në Kolegjin e përbërë nga:

Nicolas Bratza, kryetar
Lech Garlicki
Iovanni Bonello
Ljiljana Mijovic
Paivi Hirvela
Ledi Bianku
Nebojsha Vuciniĉ, gjyqtarë
dhe Fatos Araci, zëvendësregjistrues i seksionit,
pasi diskutoi në seancë me dyer të mbyllura më 29 qershor 2010,
shpall këtë aktvendim, që u miratua në këtë datë:

PROCEDURA

1. Çështja lindi mbi bazën e një aplikimi (nr.609/07) kundër Republikës së Shqipërisë, drejtuar Gjykatës në bazë të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Konventa) nga gjashtë shtetas shqiptarë, z. Refat Puto, znj. Violeta Puto, znj. Saime Puto, Z. Pandi Allabashi, znj. Ermira Allabashi dhe znj. Roza Allabashi (aplikantët), më 16 nëntor 2006.

2. Aplikantët përfaqësoheshin nga znj. S. Puto, avokate në Tiranë. Qeveria Shqiptare (Qeveria) përfaqësohej nga agjentja e atëhershme e saj, znj. S. Meneri.

3. Aplikantët pretendonin se kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës për sa i përket kohës së gjatë të mosekzekutimit të një vendimi gjykate të formës së prerë. Ata mbështeteshin edhe në nenin 13 lidhur me nenin 6 § 1 të Konventës për sa i takon mungesës së një rekursi të efektshëm dhe nenit 1 të Protokollit nr.1 të Konventës për sa i takon ndërhyrjes shpërpjesëtimore në të drejtën e tyre të pasurisë.

4. Më 14 shkurt 2008, kryetari i seksionit, të cilit iu caktua lënda, vendosi të njoftojë Qeverinë për aplikimin. Në bazë të dispozitave të nenit 29 § 3 të Konventës, u vendos të shqyrtohen meritat e aplikimit, në të njëjtën kohë me pranueshmërinë e tij.

5. Më 24 korrik 2008, kryetari i seksionit vendosi, në bazë të rregullit 38 § 1 të Rregullave të Gjykatës, se komentet e Qeverisë nuk duhet të përfshihen në dosjen e çështjes për shqyrtim nga Gjykata, sepse janë dorëzuar pas afatit kohor dhe nuk ishte bërë as kërkesë për zgjatjen e këtij afati kohor, as u dha ndonjë arsye nga Qeveria për mosrespektimin e afatit kohor.

6. Më 2 shtator 2008, aplikantët paraqitën komentet e tyre, së bashku me pretendimet për kompensim të duhur, të cilave Qeveria iu përgjigj.

FAKTET

1. RRETHANAT E ÇËSHTJES

7. Aplikantët kanë lindur në vitet 1930, 1933, 1928, 1925, 1957 dhe 1959 përkatësisht dhe jetojnë në Shqipëri dhe Austri.

A. Rikthimi i pronës dhe shpërblimi i dëmeve

8. Më 22 qershor 1994, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (Komisioni) u njohu aplikantëve titullin e pronësisë së një parcele toke dhe të një ndërtese në këtë tokë. Meqenëse punimet e ndërtimit, të cilat kishin filluar në një datë të paspecifikuar para vitit 1990, nuk ishin përfunduar, ndërtesa

ishte bërë e pabanueshme. Për këtë arsye, Komisioni u caktoi aplikantëve edhe shpërblim dëmi në shumën 997,230 lekë shqiptare (lekë).

9. Aplikantët e kontestuan shumën e shpërblimit të dëmit të caktuar nga Komisioni. Më 14 mars 1995, Gjykata të Qarkut e Sarandës, mbështetur në një raport të ekspertit, u caktoi aplikantëve shpërblim dëmi në shumën 4,600.000 lekë, rreth 33.065 euro. Ky vendim mori formë të prerë më 14 prill 1995.

10. Në një letër të datës 11 nëntor 1998, Ministri i Financave i informoi aplikantët se duheshin nxjerrë udhëzime të përbashkëta nga Ministria e Financave dhe Ministria e Drejtësisë lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore që kishin ndikim në buxhetin e shtetit.

11. Më 25 maj 2000, Gjykata e Qarkut Sarandë lëshoi një urdhër ekzekutimi në lidhje me aktgjykimin e saj të vitit 1995.

12. Në një letër të datës 5 korrik 2000, Ministria e Financave informoi aplikantët se ata duhej të kompensoheshin me obligacione shtetërore.

13. Në një letër të datës 7 nëntor 2002, z. Refat Puto i kërkoi zyrës së përmbarimit të Sarandës të ekzekutojë vendimin e gjykatës së qarkut.

14. Në përgjigje të letrës së aplikantit, Drejtori i Përgjithshëm i Përmbarimit në Ministrinë e Drejtësisë i kërkoi Përmbarimit të Sarandës më 16 shkurt 2002 të ekzekutonte vendimin e gjykatës së qarkut. Më 7 prill 2004, zyrës së përmbarimit në Sarandë iu dërgua një letër e ngjashme nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit.

15. Më 22 tetor 2005 dhe 3 mars 2006 aplikantët i dërguan dy letra Ministrisë së Drejtësisë. Asnjë përgjigje nuk u dërgua deri në datën kur aplikantët iu drejtuan kësaj Gjykate.

B. Transferimi i pronësisë së pasurisë

16. Në komentet e tyre për pretendimet e aplikantëve për kompensim të duhur, Qeveria parashtroi se më 25 prill 2002 aplikantët e kishin shitur parcelën e tokës dhe ndërtesën te persona të tretë. Në mbështetje të kësaj u paraqit kontrata e shitblerjes e lidhur me akt noterial.

17. Me një letër të datës 4 korrik 2008, zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme Sarandë vërtetoi se prona e aplikantëve u ishte transferuar personave të tretë si rrjedhojë e kontratës së shitblerjes të datës 25 prill 2002.

II. E DREJTA DHE PRAKTIKA E BRENDSHME E ZBATUESHME

18. E drejta dhe praktika e brendshme e zbatueshme është përshkruar hollësisht në çështjen *Gjyli kundër Shqipërisë,* nr.32907/07, §§ 19-27, 29 shtator 2009, dhe në çështjen *Qufaj Co. sh.p.k. kundër Shqipërisë* nr.54268/00, §§ 21-25, 18 nëntor 2004.

LIGJI

I. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

19. Aplikantët u ankuan se koha e gjatë e mosekzekutimit të vendimit të gjykatës së qarkut të datës 14 mars 1995 kishte shkelur "të drejtën e dëgjimit nga gjykata" sipas nenit 6 § 1, i cili në pjesën përkatëse, shprehet kështu:

"Në vendosjen e të drejtave dhe detyrimeve civile të tij ... çdo njeri gëzon të drejtën e një seance gjyqësore ... të paanshme brenda një kohe të arsyeshme ... nga [a] një gjykatë..."

A. Pranueshmëria

20. Në komentet e mëtejshme të saj ndaj pretendimit të aplikantëve për kompensim të duhur, Qeveria parashtroi se aplikantët nuk kishin bërë të ditur as në aplikimin e tyre, as komentet e tyre faktin se ata ua kishin shitur pronën personave të tretë në vitin 2002. Sipas pikëpamjes së saj, ky mosdeklarim kishte rëndësi në çështjen nëse aplikantët duhej të vazhdonin të ishin "viktima" brenda kuptimit të nenit 34 të Konventës.

21. Më tej Qeveria deklaroi se aplikantët e kishin paraqitur aplikimin e tyre në gjykatë përtej afatit kohor të parashikuar në nenin 35 § 1 të Konventës, që për mendimin e saj, fillonte nga momenti kur ata e kishin shitur pronën e tyre.

22. Gjykata kujton që koncepti i "viktimës" duhet interpretuar si koncept autonom dhe pavarësisht nga konceptet e së drejtës së brendshme (shih A.P.C.A, L.P.C.A., *Abid dhe 646 të tjerë kundër Rumanisë (vendim)* nr. 34746/97, 10 korrik 2001). Fjala "viktimë" në kontekstin e nenit 34 nënkupton personin e cenuar drejtpërdrejt nga veprimi ose mosveprimi në çështje, ku ekzistenca e shkeljes është e konceptueshme

edhe në mungesë të dëmtimit (*shih Amuur kundër Francës, 25 qershor 1996, § 36, Raportet e Aktgjykimeve dhe Vendimeve 1996 - III dhe Eckle kundër Gjermanisë, 15 korrik 1982 § 66, Seria A nr.51*). Më tej Gjykata vlerëson se çështja nëse një aplikant mund të pretendojë të jetë "viktimë" brenda kuptimit të nenit 34 të Konventës, nuk ka të bëjë me substancën ose përmbajtjen e së drejtës në fjalë, por vetëm me çështjen nëse lidhet me personin që mbështetet në të (*Gayduk dhe të tjerët kundër Ukrainës* (vendim), nr.4552/69, 46099/99, 47088/99, 47179/99, 47177/99, 48018/99, 48071/99, 48580/99, 48624/99, 49426/99, 49426/99, 49426/99, 50354/99, 51934/99, 51938/99, 53423/99, 53424/99, 54120/00, 54124/00, 54136/00, 55542/00 dhe 56019/00, KEDNJ 2002-VI (ekstrakte).

23. Në rastin në fjalë, Gjykata vëren se caktimi i shpërblimit të dëmeve me aktgjykim të gjykatës së qarkut të datës 14 mars 1995, i cili mori formë të prerë më 14 prill 1995, përbënte kompensim për amortizimin e ndërtesës së aplikantëve të ndodhur mbi tokën e rivendosur. Deri më sot ky aktgjykim ka mbetur pa u ekzekutuar. Që aplikantët më vonë e shitën ndërtesën, pas këtij aktgjykimi, kjo nuk e ndryshon të drejtën e mëparshme të tyre për kompensim të dëmit të shkaktuar në ndërtesën e tyre. Për rrjedhojë, ata mbeten viktima të mosekzekutimit të atij aktgjykimi. Për këtë arsye, gjykata e hedh poshtë kundërshtimin e Qeverisë.

24. Për më tepër, meqenëse aktgjykimi i gjykatës së qarkut të datës 14 mars 1995 ka mbetur i paekzekutuar deri më sot, shkelja e pretenduar është e vazhdueshme, kështu që rregulli gjashtëmujor nuk zbatohet (*shih Bushati dhe të Tjerët kundër Shqipërisë*, nr.6397/04, § 72, 8 dhjetor 2009).

25. Gjykata vlerëson se këto ankesa nuk janë qartazi të pabazuara brenda kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Për më tepër, ajo gjen se asnjë arsye tjetër për deklarimin të papranueshme të këtyre ankesave nuk është vërtetuar dhe, për këtë arsye, ato janë të pranueshme.

B. Meritat

26. Parimet e përgjithshme sipas nenit 6 § 1 të Konventës lidhur me mosekzekutimin e një vendimi gjykate të formës së prerë janë parashtruar në çështjen *Qufaj Co sh.p.k. kundër Shqipërisë*, nr. 54268/00, § 38, 18 nëntor 2004.

27. Gjykata vëren se aktgjykimi i gjykatës së qarkut i datës 14 mars 1995 ishte i formës së prerë dhe detyrues dhe se deri më sot nuk është ekzekutuar.

28. Po kështu, Gjykata vëren se shkeljet e nenit 6 § 1 të Konventës në rastet që ngrenë çështje të ngjashme me ato në këtë çështje (shih, për shembull, *Gjyli kundër Shqipërisë,* nr. 32907/07, §§ 43-47, 29 shtator 2009, dhe *Qafaj Co. sh.p.k.* cituar më lart, §§ 39-45). Ajo nuk sheh asnjë arsye që të largohet nga ato konstatime në këtë çështje.

29. Duke pasur parasysh ligjin e saj procedural në lidhje me këtë çështje, Gjykata gjen se mosekzekutimi nga autoritetet vendore i aktgjykimit të datës 15 mars 1995 të gjykatës së qarkut në favor të aplikantëve ka cenuar thelbin e së drejtës së tyre për dëgjimin nga gjykata.

30. Për këtë arsye ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

II. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 13 LIDHUR ME NENIN 6 § 1 TË KONVENTËS

31. Aplikantët u ankuan në bazë të nenit 13 të Konventës për mungesën e rekurseve të efektshme të brendshme për sa i përket mosekzekutimit të aktgjykimit të datës 14 mars të gjykatës së qarkut.

Neni 13 i Konventës parashikon që:

"Çdo njeri, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë të parashikuara në Konventë, duhet të ketë rekurs të efektshëm para një autoriteti kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në cilësi zyrtare.".

A. Pranueshmëria

32. Gjykata vlerëson se kjo ankesë nuk është qartazi e pabazuar brenda kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Për më tepër, ajo konstaton se kjo ankesë nuk është e papranueshme për ndonjë arsye tjetër. Prandaj ajo duhet të deklarohet e pranueshme.

B. Meritat

33. Gjykata vëren se Qeveria nuk e përmendi ekzistencën e një rekursi të efektshëm të brendshëm për ekzekutimin e një vendimi gjykate të formës së prerë. Për më tepër, në aktgjykimin në çështjen Gjyli të cituar më lart, Gjykata konstatoi sa më poshtë për sa i përket efektivitit të një rekursi kushtetues për mosekzekutimin e një vendimi gjykate të formës së prerë.

"58. Gjykata vëren se aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese (shih paragrafët 21-27 më lart) pranuan se ka pasur një shkelje të së drejtës së ankuesve në qasjen në drejtësi për shkak të mosekzekutimit të vendimeve të gjykatave vendore. Megjithatë gjetjet e tyre ishin deklarative, kështu që Gjykata Kushtetuese nuk ofroi ndonjë zgjidhje të mjaftueshme. Në veçanti, ajo nuk caktoi ndonjë shpërblim të ndonjë dëmi monetar ose jomonetar, as mundi të ofronte një pikëpamje të qartë për të parandaluar shkeljen e pretenduar ose vazhdimin e saj.

59. Për më tepër, Gjykata vëren se veprimet e përmbarimit nuk ishin të efektshme në këtë rast. Po kështu, Qeveria nuk e kundërshtoi ekzistencën e ndonjë rekursi tjetër parandalues alternativ që, në rrethanat e çështjes mund të ishte shfrytëzuar nga aplikanti.

60. Gjykata arrin në përfundimin se, për rrjedhojë, ka pasur shkelje të nenit 13 lidhur me nenin 6 § të Konventës.".

34. Gjykata nuk sheh arsye të arrijë në ndonjë përfundim të ndryshëm në rrethanat e kësaj çështjeje, të cilat janë të ngjashme me ato të çështjes Gjyli. Aplikantët nuk kishin asnjë rekurs për të parandaluar vazhdimin e shkeljes së të drejtave të tyre të garantuara në nenin 6 § 1 të Konventës, ose të merrnin kompensimin që u ishte caktuar.

35. Për rrjedhojë, ka pasur shkelje të nenit 13 lidhur me nenin 6 § 1 të Konventës.

III. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR.1 TË KONVENTËS

36. Aplikantët u ankuan se kishte pasur shkelje të së drejtës së tyre për gëzim të qetë të zotërimeve, të garantuar nga neni 1 i Protokollit nr.1 të Konventës, për shkak të mosekzekutimit të aktgjykimit të datës 14 mars 1995 të Gjykatës së Qarkut.

Neni 1 i Protokollit nr.1 të Konventës parashikon kështu:

"Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit të qetë të zotërimeve të tij. Askush nuk duhet të privohet nga zotërimet e tij përveç se në interes publik dhe në bazë të kushteve të përcaktuara me ligj dhe me parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozita e mësipërme nuk e cenon në asnjë mënyrë të drejtën e një shteti të zbatojë ato ligje që duken të nevojshme për të kontrolluar përdorimin e pronës në pajtim me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve të tjera apo dënimeve."

A. Pranueshmëria

37. Gjykata vlerëson se kjo ankesë nuk është qartazi e pabazuar brenda kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Për më tepër, ajo konstaton se kjo ankesë nuk është e papranueshme për ndonjë arsye tjetër. Prandaj ajo duhet të deklarohet e pranueshme.

B. Meritat

38. Gjykata rithekson se një "pretendim" mund të përbëjë "zotërim" në kuptimin e nenit 1 të Protokollit nr.1 të Konventës, nëse vërtetohet në mënyrë të mjaftueshme se është i ekzekutueshëm (*shih Rafineritë Greke Stran dhe Stratis Andreadis kundër Greqisë, aktgjykim i datës 9 dhjetor 1994, seria A nr. 301-B, f. 84, § 59*).

39. Aktgjykimi i datës 14 mars 1995 të gjykatës së qarkut u ofroi aplikantëve një pretendim të ekzekutueshëm për kompensim të dëmit të ndërtesës së tyre. Vendimi mori formë të prerë më 14 prill 1995.

40. Gjykata kujton ligjin procedural të saj, që pamundësia e një aplikanti për të siguruar ekzekutim të një aktgjykimi të formës së prerë në favor të tij, përbën ndërhyrje në të drejtën e gëzimit të qetë të zotërimeve, siç përcaktohet në fjalinë e parë të paragrafit të parë të nenit 1 të protokollit nr.1 (*shih, ndër autoritetet e tjera, Burdov kundër Rusisë*, nr.59498/00, § 40, KEDNJ 2002-III).

41. Në këtë rast Gjykata vlerëson se pamundësia e aplikantëve për të siguruar ekzekutim të aktgjykimit të formës së prerë në favor të tyre përbënte ndërhyrje në të drejtën e gëzimit të qetë të zotërimeve të tyre, brenda kuptimit të nenit 1 të Protokollit nr.1. Duke mos zbatuar aktgjykimin e datës 14 mars 1995 të Gjykatës së Qarkut, autoritetet kombëtare ua kanë pamundësuar aplikantëve të marrin paratë, të cilat ata i gëzonin për shkak të një aktgjykimi *res judicata* në dobi të tyre. Qeveria nuk ofroi ndonjë justifikim objektiv për vonesën në ekzekutimin e aktgjykimit të gjykatës vendore.

42. Si përfundim, ka pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit nr.1.

IV. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

43. Neni 41 i Konventës parashikon:

"Në rast se Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj, dhe nëse e drejta e brendshme e palës së lartë kontraktuese në fjalë lejon vetëm dëmshpërblim të pjesshëm, Gjykata i ofron palës së dëmtuar, nëse është e nevojshme, kompensim të duhur."

A. Dëmi

44. Aplikantët kërkuan 61,036 euro si dëmtim monetar, që përbëhej nga shuma e caktuar nga aktgjykimi i datës 14 mars 1995 të gjykatës së qarkut dhe humbja e interesit bankar, duke hamenduar që paratë do të ishin depozituar në një llogari kursimi. Ata kërkuan 10,000 euro për dëmtim jomonetar.

45. Qeveria i kundërshtoi pretendimet e aplikantëve.

46. Gjykata vlerëson se në rrethanat e kësaj çështjeje, pagesa e shumës që shteti u detyrohet aplikantëve në bazë të aktvendimit të formës së prerë të datës 14 mars 1995 të Gjykatës së Qarkut, do t'i rivendoste aplikantët sa më shumë të ishte e mundur në situatën në të cilën do të kishin qenë sikur autoritetet kombëtare ta kishin ekzekutuar aktgjykimin.

47. Për rrjedhojë, Gjykata vëren se shuma e caktuar nga autoritetet kombëtare ishte 4,600,000 lekë, afërsisht 33,065 euro. Ajo vëren më tej se mospagesa për një kohë të gjatë e shumës së caktuar nga gjykata vendore dhe vitet e pasigurisë sigurisht duhet t'u kenë shkaktuar aplikantëve dëm monetar që, të paktën pjesërisht, duhet kompensuar. Gjykata e vlerëson të arsyeshme se ata do të kishin tentuar ta investonin shumën e parave të caktuara më 14 mars 1995 (*shih, mutatis mutandis, Prodan kundër Moldavisë, nr. 49806/99, §§ 71-75, KEDNJ 2004-III (fragmente*).

48. Për sa i takon dëmit jomonetar, Gjykata pranon se aplikantët vuajtën shqetësim që do të ishte shmangur në rast se autoritetet do ta kishin ekzekutuar aktgjykimin e formës së prerë.

49. Duke bërë vlerësimin e saj në baza të barabarta, siç kërkohet nga neni 41 i Konventës, Gjykata u cakton aplikantëve shumën e përgjithshme prej 65,000 eurosh për dëmin monetar dhe jomonetar. Kjo shumë do të shndërrohet në monedhën vendase të shtetit të paditur me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së pagesës.

B. Shpenzimet

50. Aplikantët kërkuan 3,670 euro për shpenzimet e pësuara para kësaj Gjykate. Ata paraqitën një faturë të vetme që përmbante zërat e hollësishëm të shpenzimeve të pretenduara të bëra.

51. Qeveria i kundërshtoi shpenzimet e aplikantëve, sepse ata nuk kishin paraqitur dëftesë për çdo zë të shpenzimeve që pretendohej se ishin bërë.

52. Gjykata vëren se çështja nuk ishte e ndërlikuar. Duke pasur parasysh të dhënat e pretendimit të paraqitur nga aplikantët, Gjykata u cakton atyre, për procedimin e çështjes në Strasburg, shumën e 2,000 eurove.

C. Interesi i krijuar

53. Gjykata vlerëson të përshtatshme që interesi i krijuar duhet të bazohet në normën margjinale të interesit të huadhënies të Bankës Qendrore Europiane, së cilës i duhen shtuar tri pikë përqindjeje.

PËR KËTO ARSYE, NË MËNYRË TË NJËZËSHME GJYKATA:

1. *E shpall* aplikimin të pranueshëm.

2. *Shpall* se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës për shkak të mosekzekutimit të aktgjykimit të datës 14 mars 1995 të gjykatës së qarkut.

3. *Shpall* se ka pasur shkelje të nenit 13 lidhur me nenin 6 § 1 të Konventës për sa i përket mungesës së rekursit të brendshëm të efektshëm lidhur me mosekzekutimin e aktgjykimit të datës 14 mars 1995 të Gjykatës së Qarkut.

4. *Shpall* se ka pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit nr.1 të Konventës për shkak të mosekzekutimit të aktgjykimit të datës 14 mars 1995 të gjykatës së qarkut.

5. *Shpall:*

a) se shteti i paditur duhet t'u paguajë aplikantëve, brenda tre muajve nga data në të cilën aktgjykimi merr formë të prerë sipas nenit 44 § 1 të Konventës, shumat e mëposhtme, që duhet të shndërrohen në monedhën vendase të shtetit të paditur me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së pagesës:

i) 65,000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë) euro, plus çdo taksë që mund t'u vihet në ngarkim aplikantëve,

për dëmin monetar dhe jomonetar;

ii) 2,000 (dymijë) euro, plus çdo taksë që mund t'u vihet në ngarkim aplikantëve, për shpenzimet e kryera.

b) se, nga skadimi i afatit tremujor të lartpërmendur deri në momentin e pagesës mbi shumat e mësipërme, të paguhet interes i thjeshtë, i cili duhet të jetë i barabartë me normën margjinale të interesit të huadhënies të Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës në fjalë, plus tri pikë përqindjeje.

6. *Rrëzo*n pjesën tjetër të pretendimit të aplikantëve për kompensim të duhur.

Përpiluar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 20 korrik 2010, në bazë të Rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullave të Gjykatës.

Fatos Araci	Nicolas Bratza
Zëvendësregjistrues	Kryetar